



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:103103
Datë: 03.09.2024
Numri i dokumentit: 06117432

K.DH.SH.II.nr.1499/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit “G...C...” dhe “Y.P.” Sh.p.k me seli në Gjakovë, përfaqësuar nga Korab Bokshi, avokat nga Gjakova, Rr. Tirana nr.40 kati i tretë, kundër të paditurës-kundërpropozuesi, Komuna e Gjakovës, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.284/24 të datës 13.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditësit-propozuesi “G...C...” dhe “Y.P.” Sh.p.k me seli në Gjakovë, ndërsa VËRTETOHET Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.284/24 të datës 13.06.2024.

A r s y e t i m i

1 (5)

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, është vendosur si në vijim; REFUZOHET propozimi i paditësit “G...C...” dhe “Y.P.” Sh.p.k me seli në Gjakovë, për shtyrje të vendimit nr. 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024 si e pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditësi, për shkak të shkeljeve të renda të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar, përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të prish aktvendimin e Dhomës së Shkallës së Parë duke e kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura duke konsideruar se aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë KA.nr.166/24 datë 23.04.2024 është i drejtë dhe i bazuar në ligj, kurse pretendimet e paditësit si në ankesën e tij janë të pa bazuara, të pa argumentuara dhe nuk e sjellin në dyshim ligjshmërinë e aktvendimit. Andaj ka propozuar që Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë të nxjerrë aktvendim që të refuzoj në tërësi ankesën e paditësit/propozuesit duke lënë në fuqi aktvendimin e Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.166/24 të datës 23.04.2024.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi “G...C...” dhe “Y.P.” Sh.p.k me seli në Gjakovë, pranë Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, ndaj vendimit nr.01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024. Paditësi së bashku me padi, ka propozuar - kërkuar edhe shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ përfundimtar - vendimit me nr.01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024 të paditurës Komuna e Gjakovës.

Dhoma e Shkallës së Parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, gjykata vlerëson se paditësi nuk e ka bërë të besueshëm pretendimin se ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej. Ka shtuar se pretendimi se për të njëjtën paluajtshmëri është iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Komerciale të Kosovës me KA.nr.1166/22 dhe kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ të kundërshtuar e cila i është refuzuar me lëndën KA.nr.1166/22, nuk është dëshmi se paditësit i shkaktohet dëm vështirë i riparueshëm, pasi që objekt i padisë në këtë çështje administrative është e nejtë paluajtshmëri por bëhet fjalë për dy procedura të ndara administrative, ndërsa sa i përket vendimit të kundërshtuar me të cilin ka përfunduar procedura e Ankandit Publik nr.01-96302-1251 datë 29.01.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vit të pronës së paluajtshme komunale me nr. parcelës P-10705029-016371-1 paditësi nuk ka dëshmuar se është dëmtuar në këtë procedurë sepse i njëjti nuk ka marrë pjesë në këtë procedurë, pra nuk ka shpreh interesim të marrë pjesë në ankand publik. Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka arritur të dëshmoj duke u mbështetur me prova se ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit, si kriter i parë ligjor nga neni 22 par.2 të LKA-së, ndërsa sa i përket kushtit të dytë se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe kushtin e tretë se shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar, paditësi nuk i ka elaboruar fare. Ka cek se paditësi nuk e ka arsyetuar se pse dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale një palë e tretë përmes ankandit publik është në kundërshtim me interesin publik. Ndër të tjera ka theksuar se pretendimet e paraqitura nga paditësi lidhur me kundërligjshmërinë e aktit të kundërshtuar si dhe pretendimet tjera të paraqitura në padi, gjykata do ti shqyrtoj në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadiës, por që këto pretendime nuk janë me ndikim në rastin e vlerësimit të besueshmërisë së kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrativ.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në

kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të caktohet shtyrja e ekzekutimit të vendimit 01.nr.07/01-2942 të datës 27.02.2024, e lëshuar nga e paditura, deri në vendosjen meritore të kërkesëpadisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të Dhomës së Shkallës së Parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore e për këto pretendime gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Departamenti Fiskal, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit. Meqë në këtë rast paditësi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme sepse nga provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës nuk e arsyetojnë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ në këtë rast, ngase nuk dëshmojnë se pa shtyrjen e vendimit kontestues do të shkaktonte dëm të pariparueshëm apo se ekziston rreziku i shkakimit të dëmit apo humbjeve të tjera, andaj edhe kolegji i kësaj gjykate gjenë se paditësi-propozuesi me prova të cilat ja ka bashkangjitur kërkesës në fjalë nuk janë bindëse dhe nuk e mbështetin pretendimet e paditësit-propozuesit se ekziston mundësia e shkakimit të dëmit apo humbje të tilla, andaj, kolegji i kësaj gjykate erdh në përfundim se propozuesi-paditësi kërkesën për shtyrje të ekzekutimit nuk e ka bërë të besueshëm me prova bindëse dhe konkrete, që me ekzekutimin e vendimit kontestues do

të mund të shkaktohet ndonjë dëm të pariparushëm, e cila do të mund të riparohej me vështërsi, ashtu siç parashihet me nenin 22 paragrafi 6 e lidhur me paragrafin 2 të LKA-së.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoj të gjitha pretendimet ankimore por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim ndryshe në vendosje lidhur më këtë rast, andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr. 1499/24 datë 02.09.2024

Kryetarja e Kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri